



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.264/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, për shkak të presionit tek votuesit dhe blerjes së votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa **Anr.264/2017** e datës 12.06.2017, me të cilën është pretenduar se Koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka bërë presion tek votuesit dhe blerje të votës.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se gjatë ditës votimit në fshatin Kçiç i Madh, në afërsi të shkollës fillore “Bislim Imeri”, me numër të vendvotimit 1112B, koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka ushtruar presion tek votuesit dhe blerje të votave. Më këtë rast pretendohet se është bërë shkelje e nenit 215 të Kodit Penal.

PZAP-i, me datë 13.06.2016, ka pranuar një raport informues nga Policia e Kosovës, Njësia e Hetimeve-Stacioni Policor Jugor-Mitrovicë, ku theksohet se me datën 11.06.2017, rreth orës 11.45, kanë pranuar një thirrje nga Zyrtarët Policor në fshatin Kçiç për një problem në qendër të votimit nr. 1112B. Së bashku me prokurorin kanë dalë në vendin e ngjarjes ku kanë kontaktuar me Imer Fejza dhe Rejhan Fejza, të cilët kanë njoftuar se në një shtëpi e cila gjendet përballë shkollës në Kçiç, dyshohet se subjekti politik PDK, ka ushtruar presion ndaj votuesve dhe dyshohet për blerje të votave, por nuk ka pasur persona të identifikuar me emër për të cilët dyshohet se kanë bërë presion ndaj votuesve.

Nga ana e Policisë është kontrolluar shtëpia në fjalë dhe askush nuk ka qenë aty, është vërtetuar se është shtëpi e pa banuar dhe se e njëjta shtëpi nuk ka as dyer e as dritare. Po ashtu prokurori ka kërkuar që të merren masa shtesë rreth këtij vendvotimi.

PZAP-i, pas shqyrtimit ankesës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se në afërsi të shkollës “Bislim Imeri”, fshatin Kçiç i Madh, monitoruesi i tyre ka vjetur se koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka ushtruar presion tek votuesit dhe blerje të votave.

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së. Po ashtu, nuk është e specifikuar që ushtrimi i presionit dhe blerja e votave është bërë brenda rrethojave të vendvotimit por thuhet në afërsi të qendrës së vendvotimit dhe se në rastin konkret nuk ka persona të identifikuar nga Policia lidhur me pretendimet ankimore, ndërsa parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë për ti provuar pretendimet e tij si në ankesë, e në raste se pala ofron prova të reja në kuptim të nenit 118, paragrafi 4 të LPZ-së, PZAP do ta rishqyrton vendimin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.264/2017 më datën 13.06.2017

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24)orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi